



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 59

Tiranë – E premte, 15 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 20, datë 10.3.2016	Për Programin Operacional për Zhvillimin e Rajoneve 2016-2017. 3671
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1783, datë 11.4.2016	Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ruga hyrëse Berat” (shtesa), për pasuritë e llojit “trual”..... 3681

**VENDIM****Nr. 20, datë 10.3.2016**

**PËR PROGRAMIN OPERACIONAL PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE
2016–2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Operacional për Zhvillimin e Rajoneve, 2016–2017, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

**PROGRAMI OPERACIONAL
PËR ZHVILLIMIN RAJONAL
2016–2017**

I. HYRJË

Programi Operacional për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve është dokumenti kuadër për funksionimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve

për periudhën 2016–2017.

Dokumenti është hartuar në përputhje me detyrimet në kuadër të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, aneksi 3, i cili specifikon modalitetet e funksionimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

**II. KUADRI STRATEGJIK I POLITIKËS SË
ZHVILLIMIT RAJONAL**

1. Sfidat e zhvillimit të politikës

Sot ekziston nevoja për të zhvilluar një politikë dhe një platformë të qartë e koherente për zhvillimin rajonal. Qasja e zbatuar deri më tani ka pasur kryesisht orientim dhe programe sektoriale, duke adresuar kështu nevojën e financimit me dimension hapësinor/territorial, me fokus zhvillimin e rajonit, përmes ndërhyrjeve të integruara dhe prerjes midis sektorëve, në disa akse prioritare.

Rishtazi është prezantuar koncepti i akteve prioritare, programeve të shtyllave të financimit, koncepti i zonave të Zhvillimit Rajonal, si përpjekje e parë për përafrimin me Fondin Evropian për Zhvillimin e Rajoneve.

Po punohet për të hartuar një politikë (komplekse) kombëtare të zhvillimit rajonal, dhe miratuar akte të tjera ligjore të lidhura me të, dhe përmirësime të tjera për zbatimin e politikës (referuar reformës për zhvillimin rajonal), sidomos nën prespektivën drejt BE-së dhe përafrimit me politikën e kohezionit të BE-së dhe fondeve strukturore (kapitulli 22).

**2. Konteksti i politikës rajonale të BE-së për
Zhvillimin Rajonal**

Në Evropë, zhvillimi rajonal nuk është një koncept i ri dhe qasja ndaj zhvillimit rajonal ka përparuar dhe është transformuar nga një politikë shtetërore subvencionesh, në një politikë që synon inkurajimin e rajoneve (territoreve) për të gjeneruar zhvillim, duke vënë në përdorim burimet e tyre dhe duke konkurruar midis tyre. Po ashtu, edhe dimensionin territorial po fiton gjithnjë e më shumë hapësirë në formulimin dhe zbatimin e politikave evropiane.

Komponenti për zhvillimin rajonal mbështet politikën e zhvillimit rajonal dhe përgatitjen për administrimin dhe zbatimin e politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian. Në mënyrë të veçantë:

Më 1974-n, në Samitin e Parisit, liderët politikë vendosën të formojnë Fondin Evropian për



Zhvillim Rajonal (1975). Ky fond u fokusua për të stimuluar aktivitetet ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës në rajonet më pak të zhvilluara.

Në vitet 1988–1993 fondet strukturore u integruan drejt një politike gjithëpërfshirëse kohezionale, duke u fokusuar në rajonet më të varfra dhe më të prapambetura, drejt programeve, orientimeve të investimeve strategjike, si dhe në përfshirjen e partneritetit rajonal dhe lokal. Buxheti i alokuar arrinte në 64 bilionë euro.

Në vitet 1994–1999, përmes Traktatit të Mastrihtit (1993) u futën tri risi:

- Fondi i Kohezionit;
- Komiteti i Rajoneve;
- Parimi i Subsidiaritetit.

Gjatë kësaj periudhe burimet për fondet strukturore dhe të kohezionit u dyfishuan, duke arritur një të tretën e buxhetit të BE-së (168 bilionë euro).

Në periudhën 2000–2006 strategjia e Lisbonës (viti 2000) përcaktoi prioritetet e BE-së në drejtim të rritjes, hapjes së vendeve të punës dhe inovacionit. Buxheti i alokuar për 15 vendet anëtare ekzistuese (213 bilionë euro), ndërsa për vendet e reja anëtare (22 bilionë euro).

Në periudhën 2007–2013 buxheti i alokuar ishte 347 bilionë euro (e cila 25% ishte destinuar për hulumtim dhe inovacion dhe 30% për infrastrukturën e mjedisit dhe masave për të luftuar ndryshimet klimaterike). Ky investim synonte të nxiste rritjen rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Madje edhe strategjia “Europa 2020”, e cila paraqet një projeksion 10-vjeçar të komunitetit, vazhdon të shënjestrojë objektivat e politikës së kohezionit, me qëllim realizimin e një rritjeje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Strategjia “Europa 2020” nuk prek vetëm vendet anëtare të BE-së, por, përkundrazi, ofron një mbështetje të konsiderueshme edhe për vendet kandidate dhe kandidate potenciale dhe i ndihmon ato të projektojnë përpjekjet e tyre për reforma. Kjo sigurisht nënkupton që vendet anëtare, dhe jo vetëm, duhet të përpiqen të përkthejnë objektivat e BE-së në objektivat e veta kombëtarë.

Si pjesë e objektivave për të promovuar zhvillimin rajonal, FEZHR-ja dha kontribut drejt financimit kryesisht të masave të mëposhtme:

Konvergjencat:

- modernizimin dhe diversifikimin e strukturave ekonomike;

- krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës;
- stimulimin e rritjes ekonomike;
- përmirësimin e zonave urbane, malore, më pak të banuara etj.

Konkurrenca rajonale dhe punësimi:

- inovacioni dhe njohuri ekonomi (p.sh.: hulumtim dhe zhvillim teknologjik, risi dhe sipërmarrje etj.);

- mjedisi dhe parandalimi i rrezikut (p.sh., pastrimin e zonave të ndotura, efikasiteti i energjisë, transporti urban, planet e parandalimit të rrezikut);

- qasje në transport dhe telekomunikacion - bashkëpunimi territorial;

- aktivitetet ndërkufitare ekonomike, sociale, mjedisore dhe bashkëpunimin transnacional, duke përfshirë bashkëpunimin bilateral ndërmjet rajoneve;

- bashkëpunimi ndërrajonal, duke përfshirë krijimin e rrjeteve dhe shkëmbimin e përvojave në mes të autoriteteve rajonale dhe lokale.

Në periudhën 2014–2020, buxheti i alokuar është 351.8 bilionë EUR me një fokus të veçantë në katër prioritetet kryesore të investimit: hulumtimin dhe inovacionin, agjendën digjitale, mbështetjen për SME-të dhe ekonominë e ulët e karbonit. Rreth 100 bilionë EUR do të jetë e dedikuar për këta sektorë, nga të cilat 26.7 bilionë EUR do të mbështesë kalimin në një ekonomi të ulët të karbonit (eficiencën e energjisë dhe energjinë e rinovueshme). FEZHR-ja do të investojë për të nxitur konkurrencën dhe për të krijuar vende pune në të gjitha rajonet e BE-së. Veprimet FEZHR janë të perceptuara për të adresuar sfidat ekonomike, mjedisore dhe sociale, me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban (mbi 50% e investimit do të jetë në zonat urbane).

FEZHR-ja për 2014–2020, fokuson investimet në disa fusha prioritare. Kjo është e njohur si “përqendrimet tematike”:

- inovacioni dhe hulumtim;
- axhenda digjitale;
- mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME).

Ekonominë e ulët të karbonit:

Burimet e alokuara të FEZHR-së në këto prioritet do të varen nga kategoria e rajonit:

- në rajonet më të zhvilluara, të paktën 80% e fondeve do të përqendrohen në të paktën dy nga këto prioritet;



- në rajonet në tranzicion 60% e fondeve;
- në rajonet më pak të zhvilluara 50%.

Për më tepër, disa burime të FEZHR-së do të kanalizohen në mënyrë specifike ndaj projekteve për një ekonomi më të ulët të karbonit:

- rajone të zhvilluara: 20%;
- rajonet e tranzicionit: 15%; dhe
- më pak të zhvilluar: 12%.

Karakteristikat specifike territoriale

- FEZHR-ja, gjithashtu, i jep vëmendje të veçantë karakteristikave specifike territoriale. Masat e FEZHR-së janë projektuar për të reduktuar problemet ekonomike, mjedisore dhe sociale në zonat urbane me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban. Të paktën 5% e burimeve të FEZHR-së janë të vendosura përmes “veprime të integruara” të menaxhuara nga qytetet.

- Zonat e disavantazuara nga një këndvështrim gjeografik (zonat e largëta malore ose zonat me popullsi të ulët) përfitojnë nga trajtimi i veçantë. Së fundmi, zonat larg qendrës gjithashtu përfitojnë nga ndihma specifike e FEZHR-së për të trajtuar disavantazhet e mundshme për shkak të largësisë së tyre.

3. Kuadri ligjor për zhvillimin rajonal

Në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarr nga qeveria shqiptare, me asistencën e partnerëve ndërkombëtar, si: ADA, GIZ, SDC etj., po punohet për zhvillimin e politikës kombëtare për zhvillimin rajonal në terma afatgjatë, hartimin e ligjit për zhvillimin rajonal, i cili pritet të progresojë gjatë vitit 2016, si dhe Programi Operacional për Zhvillimin e Rajoneve. Krahas përthithjes së praktikave më të mira të Bashkimit Evropian, nëpërmjet këtij kuadri zhvillimi, do të arrihet konkretizimi i prioriteteve kombëtare të zhvillimit rajonal, arritja e objektivave për një kohezion territorial, me qëllim pasjen e rajoneve me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Në dhjetor të vitit 2015, me vendim i Këshillit të Ministrave nr. 961, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, janë miratuar 4 zonat e zhvillimit rajonal, si dhe strukturat zbatimit të politikës kombëtare për zhvillimin rajonal.

Krahas ligjit për zhvillimin rajonal, përgjatë procesit të reformës për zhvillimin rajonal do të

hartohet Programi Operacional të Zhvillimit Rajonal, në nivel Kombëtar, si dhe profilet analitike për secilin rajon zhvillimi, për t’u përkthyer më pas në Programe Operacionale të Zhvillimit të Rajonit përkatës. Këto programe do të jenë dokumente të hartuara nga një perspektivë e sfidave, të nevojshme për të nxitur më tej zhvillimin në nivel rajonal e më gjerë atë në nivel kombëtar dhe procesin e negociatave dhe integritit në BE.

4. Kuadri Strategjik për Zhvillimin Rajonal

Programi i qeverisë përcakton si prioritetet politike për rajonalizimin (ndarja e vendit në rajone) dhe reformën rajonale. Programi lidhet me: i) krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të rajoneve dhe vetqeverisjes; ii) udhëheqjen e re lidhur me politikat zhvillimore kombëtare dhe rajonale; iii) rritjen e funksioneve dhe kompetencave të njësive ekonomike të qeverisë shqiptare në nivel rajonal; iv) rritja e burimeve financiare dhe asetëve në rajonet respektive; v) modeli i ri dhe më efikas për autoritetet qendrore dhe lokale në nivel rajonal; vi) reforma vendimtare për përfshirjen e Shqipërisë si një vend kandidat i BE-së; vii) mbështetje teknike dhe fonde nga instrumentet e BE-së për fuqizimin e rajoneve. Programi i qeverisë shqiptare në mënyrë të qartë ofron mundësi për krijimin e rajoneve në përputhje me parimet e Kartës Evropiane.

Ky këndvështrim i orienton rajonet të përqendrohen në çështjet e zhvillimit rajonal dhe për këtë qëllim të përfitojnë jo vetëm nga burimet e brendshme, por edhe nga burimet e BE-së. Kjo lë hapësirë për një rishikim të gjerë të institucioneve të dekoncentruara në nivel rajonal, duke përfshirë edhe kompetencat e tyre.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) për periudhën 2015–2020 është dokumenti themelor strategjik është hartuar nga qeveria shqiptare. SKZHI-ja orienton politikat kombëtare me qëllim arritjen e standardeve të nevojshme për integrimin e vendit në BE, si dhe zhvillimin e balancuar të vendit përmes bashkëpunimit midis qarqeve/rajoneve të vendit, duke rritur kështu konkureshmërinë globale të vendit. SKZHI-ja përfshin, gjithashtu, programin e qeverisë “Për të transformuar Shqipërinë në një model që frymëzon paqen dhe zhvillimin në rajon”. SKZHI-ja ofron kornizën strategjike për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe është shtylla kryesore e Sistemit të Planifikimit të



Integruar (SPI).

Sfidat kryesore që mbeten për t'u adresuar gjatë periudhës së planifikimit për vitet 2015–2020 përmbledhen:

- nevoja për adresimin e zhvillimit të pabarabartë midis rajoneve brenda vendit dhe në kontekstin ndërkombëtar;

- balancimi i zhvillimit midis rajoneve dhe brenda bashkive, midis zonave urbane dhe atyre rurale dhe midis zonave bregdetare dhe atyre periferike malore;

- trajtimi i aspekteve që lidhen me migrimin dhe emigrimin (brenda dhe jashtë vendit);

- trajtimi i aspekteve që lidhen me mbipopullimin në zonat më të zhvilluara dhe largimit nga zona të tjera;

- nevoja për trajtimin e dobësive në kuadrin e politikave dhe kapaciteteve institucionale.

SKZHI-ja paraqet shtyllat kryesore të vizionit të politikës së zhvillimit rajonal në vend, duke orientuar drejt objektivave të mëposhtëm:

1. Nxitja e konkurrueshmërisë mes rajoneve, përmes nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve të tyre, duke ofruar:

- mbështetje për të siguruar zhvillim ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe ofrimit të arsimit profesional duke iu përgjigjur nevojave të tregut të punës;

- përmirësimi i infrastrukturës lidhëse midis dhe brenda rajoneve;

- zgjerim i funksioneve të zonave dhe diversifikim të ekonomive rurale;

- nxitja e përdorimit të burimeve unike social-ekonomike e kulturore të rajoneve.

2. Rritje e kohezionit rajonal, nëpërmjet uljes së pabarazive ekzistuese në shfrytëzimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, nëpërmjet:

- përmirësimin të standardeve të infrastrukturës publike dhe rrjeteve të shërbimeve;

- sigurimit të mbrojtjes rajonale të integruar të mjedisit;

- sigurimit të rritjes së investimeve publike në rajonet më pak të zhvilluara.

3. Menaxhim efektiv i zhvillimit rajonal, nëpërmjet një nxitje të re e pragmatike për zhvillimin rajonal, duke përdorur me efikasitet burimet e kufizuara manaxheriale nëpërmjet:

- ndërtimit të kapaciteteve për zhvillimin rajonal në të gjitha nivelet qeverisëse;

- krijimit të mekanizmave efikasë dhe eficientë për menaxhimin e zhvillimit rajonal;

- përmirësimin të bashkëpunimit ndërsektoriale dhe aplikimi i qasjes territoriale të zhvillimit;

- përmirësimin të koordinimit në procesin e hartimit të strategjive përmes përfshirjes së aktorëve rajonalë, për të garantuar që strategjitë sektoriale (koordinimi vertikal) marrin në konsideratë specifikat rajonale, si edhe strategji dhe programe rajonale që integrojnë objektivat e strategjive sektoriale;

- krijimit të një sistemi monitorimi të kombinuar me zbatimin e strategjive rajonale në nivel rajonal, sipas të njëjtave standarde të vendosura nga qeverisja qendrore.

Gjithashtu, SKZHI-ja paraqet një nxitje gjithëpërfshirëse për decentralizimin dhe forcimin e qeverisjes lokale, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale dhe me parimet mbi qeverisjen lokale të sanksionuara në dokumentet administrative evropiane, me qëllim sigurimin politik, decentralizimin administrativ dhe fiskal.

Reforma administrative territoriale shënoi një pikë kthese historike në organizimin administrativo-territorial të Shqipërisë. Më 31 korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Reforma territoriale-administrative (TAR) ka qenë në fokusin e qeverisë së Shqipërisë, me miratimin e organizimit të ri administrativ të nivelit të parë të qeverisjes vendore në Shqipëri, në 61 bashki në vend të 373 komunave ekzistuese dhe bashkive. Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020 (SKNDQV) paraqet vizionin e qeverisë shqiptare për forcimin e demokracisë vendore dhe përparimin e procesit të decentralizimit sipas standardeve më të përparuara evropiane. Qëllimet dhe objektivat e kësaj strategjie përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 për zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritetit evropian.

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015–2020 prezanton një përjasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore



në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, si edhe me parimet për qeverisjen vendore të dokumentit të Hapësirës Administrative Evropiane, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Programi operacional ka marr në konsideratë dhe një sërë strategjish sektoriale dhe ndërsektoriale, të lidhura me drejtumet dhe programet e financimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Mekanizmat institucionalë dhe instrumentetë financiarë për zhvillimin e rajoneve

I vetmi instrument, i cili adresonte praktikisht dhe pjesërisht disa nga çështjet e zhvillimit rajonal, ishte Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Gjatë viteve 2006–2009, ka funksionuar në formën e Grantëve Konkurruese, për të cilat ka shërbyer si organ vendimmarrës Komiteti për Shpërndarjen e Grantit Konkurrues. Urdhri i ministrit të Financave nr. 355, datë 13.1.2009, përcakton ngritjen e Komitetit për Shpërndarjen e fondeve të Grantit Konkurrues (KGK). Ky fond, përbënte një rikonceptim të grantëve konkurruese të zbatuara, me qëllim shpërndarjen e fondeve qendrore për investime kapitale te njësitë e qeverisjes vendore, mbi baza konkurruese, çka e bënte atë më shumë të orientuar nga projektet se sa një mjet të vërtetë që adreson zhvillimin rajonal.

Në vitin 2009, në bazë të ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009, “Për buxhetin e shtetit 2010”, aneksi 3, ngrihet Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Që prej këtij viti, ministritë përkatëse, sipas sektorëve të financimit, parashikojnë në programet e tyre buxhetore, vjetore dhe 3-vjeçare, fondin e dedikuar për zhvillimin e rajoneve.

Përmes këtij mekanizmi janë financuar programe me një vendimmarrje kolegjiale përmes Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të kryesuar nga Kryeministri. Ky mekanizëm ka kryer destinimin e financimit për këto programe:

- Programi i infrastrukturës vendore: financimi buron nga ligji i buxhetit.

- Programet nga buxhetet e ministrive: me burim financimi një përqindje nga programet respektive të ministrive të linjës. Programet më domethënëse nga pikëpamja e financimit janë:

- programet për arsimin (bazë, të mesëm, të lartë); dhe

- programi për ujësjellës-kanalizimet;

Programe të tjera nga ministritë janë edhe programi për artin-kulturën; programi për pyllëzimin; programi për shëndetësinë (shërbimin parësor).

5.1 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Gjatë periudhës 2009–2013, FZHR-ja financoi projekte të ndryshme, në një vlerë totale financimi, në këto 5 vite, prej 36.8 miliardë lekë, orientuar kryesisht në zona rurale dhe infrastrukturë rrugore.

Për vitin 2014, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, orientua për financimin e projekteve të reja, si dhe financimin e detyrimeve të prapambetura për projektet në vazhdim, të periudhës 2012–2013. Përkatesisht, financimi i 210 projekteve të reja, në vlerën e 7.5 mld lekëve, dhe financimi i 164 projekteve në vazhdim, në vlerën e 2.6 mld lekëve, për një total zarfi financiar rreth 10.1 mld lekë.

Në vitin 2015, pasi Shqipëria mori statusin kandidat, prespektiva evropiane e vendit u bë më e afërt. Për këtë, filloi procesi i përafrimit të FZHR-së, me politikat dhe mekanizmat e Fondit Evropian të Zhvillimit të Rajoneve (European Regional Development Fund, nën Cohesion Policy të BE-së), duke sjellë risi, si:

- Përfshirja, për herë të parë në të e programit “Shqipëria dixhitale”, si një nga shtyllat kryesore të FZHR-së, që për analogji është “baza” e dy prej “priority axis” të FEZHR-së të BE-së: inovacion dhe ICT;

- Përmirësimi i mekanizmave të menaxhimit për zhvillim rajonal, duke vendosur me instrumente nxitëse të krijimit të tyre, dy konceptet e “partneritetit ndërvendor” dhe “partneritetit rajonal”, për të stimuluar krijimin e aktorëve të zhvillimit rajonal dhe përgatitur vendin drejt performancës së fondeve strukturore me konceptin e BE-së.

- Përfshirja e konceptit të programeve operacionale (sipas rregulloreve të BE-së për FEZHR-në të BE/Operational Programs), për të krijuar kapacitetet dhe traditën programuese të Shqipërisë, kur ajo të jetë e përshtatshme për Fondet Strukturore të BE-së (me negociatat) dhe të përfitojë nga financimi i FEZHR-së.

- Futja e konceptit të “partneritetin ndërvendor” dhe “partneritetin rajonal” në projektet për zbatim, duke përfshirë edhe partneritetet jo vetëm midis njësisve vendore, por edhe me partneritetet rajonale me agjencitë e zhvillimit, organizatat jofitimprurëse,



si edhe subjektet private për investimet e pjesëmarrjes.

- Vendosjen e koncepteve të “Drejtimit strategjik” në menaxhimin e Fondit, bazuar në shtyllat prioritare të investimeve dhe dokumentet e programeve dhe nënprogrameve, për të shmangur praktikën e copëtimit të fondit, sipas nevojave të vogla dhe pa impakt (ndikim) në mbështetjen e rilindjes së qendrave tona urbane dhe rajonale.

Në mbështetje të orientimit të ri strategjik për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2015 u fuqizua mbështetja për programin kombëtar “Rilindje urbane e qyteteve të bashkëjetesës komunitare”, duke akorduar për portofolin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, një fond prej rreth 100 mln USD. Destinimi i portofolit është bërë për 2 shtylla financimi përkatësisht, shtylla 1: Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal dhe shtylla 2: Shqipëria dixhitale.

Vlera e shpërndarë për financimin e 166 projekteve të reja, në vlerën e 8.5 mld lekëve, dhe 199 projekteve në vazhdim, në vlerën e 4.3 mld lekëve. Me një total financimi të 365 projekteve dhe shlyerje detyrimesh në vlerën e 12.9 mld lekë.

Për vitin 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve synon rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të politikave të investimeve publike, krijimin e rajoneve konkurruese me zhvillim të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor, në zbatim të politikës së kohezionit territorial. Drejtimit kryesore të investimeve, konsistojnë në:

- zhvillimin e infrastrukturës lokale, rajonale dhe urbane;

- mbështetjen për ekonominë; dhe

- Shqipëria dixhitale.

Programet kryesore të financimit do të jenë të orientuara drejt:


A. Fuqizimit të investimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm – mbështetja e projekteve që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit të qytetit, përmes ndërhyrjeve në qytete, rivitalizimit të hapësirave publike dhe ekonomive lokale, përmirësimi aksesit dhe lëvizshmërisë (projekte me ndikim rajonal dhe ndërrajonal), rivitalizimi i poleve urbane dhe qendrave rajonale, përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe ndërvendore.

B. Kohezioni dhe zhvillimi rajonal – orientimi i investimeve për projekte të zhvillimit rajonal të fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës së ndërveprimit ekonomik, adresojnë një nevojë të zhvillimit socio-ekonomik rajonal.

C. Stimulimi i zonave dhe cluster të zhvillimit – investimi në grupime zonash me interes turistik, bujqësor dhe potencial zhvillimi ekonomik (fshatra turistike, itinerar kulturor/trashëgimie/historik, etj.)

D. Qytetet moderne – përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike përmes platformave inovative në shërbim të qytetarëve, sistemeve dixhitale multifunksionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve dhe shërbimeve vendore dixhitale për qytetarët e biznesit.

III. PROFILET E ZONAVE TË ZHVILLIMIT RAJONAL



IV. SFIDAT DHE POTENCIALET

1. SFIDAT

1.1 Demografia

Shqipëria ka një popullsi prej 2,894,476 banorësh, nga kjo 1,433,492 banorë janë femra. Sipas të dhënave të tri regjistrimeve të fundit del se popullsia banuese e vendit tonë ka ardhur duke rënë: nga 3,182,417 banorë më 1989-n, në 3,069,275 banorë më 2001-shin dhe 2,913,019 banorë më 2010-n. Ndryshimet demografike në Shqipëri do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në dekadën e ardhshme. Sipas parashikimeve të popullsisë së Shqipërisë (2011–2031), ajo do të

përjetojë një rënie të numrit të lindjeve dhe rritja e saj natyrore do të jetë e barabartë me zero, d.m.th., lindjet do të jenë të barabarta me numrin e vdekjeve, më 2027-n. Qarku i Tiranës ka dendësinë më të lartë të popullsisë në vend me mbi 480 banorë për kilometër katror, më 2014-n. Dendësia e popullsisë në mesin e vitit 2014 është 100,7 banorë për km², një shifër e cila ka ndryshuar vetëm pak gjatë pesë viteve të fundit. Qarku i dytë me densitetin më të lartë është Durrësi me 360 banorë për km² pasuar nga qarku i Fierit me 167 banorë për km² në vitin 2014. Nga ana tjetër, ka vetëm dy qarqe dendësia e të cilave është më pak se



40 banorë për km², qarku i Kukësit dhe ai i Gjirokastrës. Meriton adresim, emigracioni dhe migrimi, braktisja e zonave rurale etj.

1.2 Ndërlidhja rajonale dhe ndërrajonale

Bashkëveprimi, krijimi i partneriteteve rajonale dhe ndërrajonale, mbetet një nga sfidat e kryesore të politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit territorial.

1.3 Situata në zonat urbane dhe rurale, si dhe diversiteti ndërrajonal

Mesatarisht, rreth 48.7% e të gjithë popullsisë banon në zonë urbane duke reflektuar një tregues mesatar të urbanizimit. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e popullsisë gjendet në zonat rurale, duke i dhënë vendit një fizionomi të zhvillimit të orientuar në aspektin rural. Pjesa e popullsisë që ka akses në sistemin e ujit është 79.8%. Ushtrojnë profesionin 6.425 mjekë (në institucionet publike dhe private) dhe janë 44 spitale. Meriton adresim, lufta për zbutjen e varfërisë, zbutja e pabarazive rajonale, promovimi dhe forcimi i ekonomive lokale, krijimi i identiteteve lokale dhe rajonale

1.4 Infrastruktura teknike për zhvillimin rajonal

Vendi zë një sipërfaqe prej 28,748 km². Sipas ndarjes së re administrative-territoriale Shqipëria ka 61 njësi vendore. Rreth 9,451 km është gjatësia e rrugëve rurale rajonale.

Shqipëria shtrihet në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Korridoret më të rëndësishme rrugore janë: rr. Tiranë-Kukës-Prishtinë, Tiranë-Librazhd-Maqedoni, Tiranë-Korçë-Greqi, Tiranë-Fier-Gjirokastrë-Kakavijë, Tiranë-Shkodër-Podgoricë. Po ashtu, ka dalje në det me portin e Durrësit, portin e Vlorës, portin e Sarandës, si dhe atë të Shëngjinit.

Ka disa pika kufitare: dy në Shkodër me Malin e Zi (Muriqan dhe Hani i Hotit), me Kosovën (Morinë, Has dhe Tropojë); me Maqedoninë me anë të pikës kufitare të Bllatës dhe të Qafë-Thanës; me Greqinë në pikat Kapshticë, Kakavijë dhe Qafë-Botë. Meriton adresim, zhvillimi i zonave rurale dhe nxitja e zhvillimit të komunikimit ndërrajonal.

2. POTENCIALET

2.1 Zhvillimi i shoqërisë së informacionit dhe teknologjisë

Shkalla e përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si telefoni celular, internet etj., është rritur vit pas viti. Vrojtime të ndryshme tregojnë se dhe përdorimi i aparateve

“smart”, tableta etj. është rritur. Përdorimi i rrjeteve sociale është në një shkallë të gjerë në vend. Gjithashtu, vërehet një trend në rritje për trafikun e komunikimeve data dhe ulje të trafikut telefonik (zanor). Kjo është një tendencë globale që reflektohet dhe në vendin tonë.

Penetrimi i internetit sipas të dhënave të publikuara nga ITU-ja për Shqipërinë vlerësohet në afër 60%, penetrimi i *broadbandit* dhe veçanërisht rritja në segmentin *mobile broadband* në nivel 37%, në fund të vitit 2013, bazuar në të gjitha llojet e pajisjeve përfshirë *smartphone* dhe tablete. Pavarësisht progresit në fushën e TIK-ut, Shqipëria ende mbetet larg nivelit mesatar jo vetëm të vendeve të BE, por edhe atyre të rajonit lidhur me aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet *broadband* dhe kjo është e lidhur me diferencën e madhe të zhvillimit që ekziston midis rajoneve të ndryshme të vendit.

Përdorimi i TIK-ut në këto disa njësi të qeverisjes vendore ka gjetur hapësirë në përmirësimin e proceseve administrative, lehtësimin e qasjes ndaj informacionit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimtarisë së pushtetit vendor, të tilla si: taksat, buxhetet, planifikimi dhe menaxhimi i territorit, inspektimi, emergjencat, përfshirja e qytetarëve e bizneseve në vendimarrje deri në modelet më të avancuara të ngritjes së zyrave me një ndalesë etj.

2.2 Turizmi dhe kultura

Turizmi mund të jetë i tri drejtimeve kryesore: për plazh (det dhe liqen); për mal dhe për atraksione kulturore (kala dhe vepra historike). Si asete natyrore janë disa, ku në veri mund të përmendet Parku Korab-Koritnik, Lura, Luzni-Bulaç, Ulza, Bjeshka e Oroshit, Korab-Koritnik, Tej Drini i Bardhë dhe Lugina e Valbonës, lumi Gash, Thethi, Vermoshi, Maranai dhe liqeni i Shkodrës.

2.3 Mjedisi dhe Infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit

Shqipëria ka potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e një turizmi që siguron zhvillim ekonomik afatgjatë dhe prosperitet social e mjedisor. Vendi ka 450 km bregdet, nga të cilat 300 km në detin Adriatik, dhe 150 km në detin Jonian. Aty gjenden rreth 24 zona potenciale, shumica ende të virgjëra, për zhvillim cilësor turizmi. Ndërkohë më shumë se gjysma e sipërfaqes së vendit janë zona malore me mbi 600 m mbi nivelin



e detit dhe aty ndodhen edhe 15 zona të tjera që kanë, gjithashtu, potencial për zhvillimin e turizmit.

Përveç potencialit të zonave turistike detare, Shqipëria ka mjaft potenciale të tjera në brendësi të vendit, përfshi: i) tri liqene (Shkodër, Ohër dhe Prespë), një rrjet liqenesh të vegjël (Dumre, Lurë etj.) dhe dhjetëra liqene artificiale. Vendi ka 15 parqe kombëtare, zona të ndjeshme ekologjike-emeralde, dhe zona të tjera pyjore kudo; ii) ekziston një trashëgimi e pasur arkeologjike e periudhave ilire, romake, helene, bizantine, veneciane, otomane etj., përfshirë: Butrintin (UNESCO), Apolloninë, Bylis dhe Durrësin. Ka edhe mjaft manastire, kisha dhe kështjella e fortifikime mesjetare. Vendi ka dy qytete muze: Beratin dhe Gjirokastrën (UNESCO), dhe mjaft të tjera me cilësi të veçanta arkitektonike; iii) kultura shqiptare ka larmi besimesh fetare, folklori, traditash dhe kostumesh popullore; shumëllojshmëri punimesh artizanale e kulinarie; njerëzit janë miqësorë e mikpritës me të huajt dhe përgjithësisht njohin gjuhët e huaja. Klima është e mirë me diell dhe me një sezon relativisht të gjatë veror.

Asetet natyrore të zotëruara nga Shqipëria kanë nevojë (pjesa më e madhe e tyre) për rehabilitim dhe për kthimin e tyre në destinacione të arritshëm. Në këtë pikë, FZHR-ja ka luajtur një rol në konvergencë me politikat e Ministrisë së Mjedisit, duke financuar projektet për pyllëzim të zonave të caktuara (si për shembull, në Sarandë, Makarësh etj.), projekte këto me rëndësi për mbrojtjen dhe rigjenerimin e mjedisit.

2.4 Bashkëpunimi ndërvendor

Ka shumë qarqe që mund të konsiderohet si shembull suksesi i bashkëpunimit ndërvendor, pasi janë bërë pjesë e disa projekteve të financuar nga burime të jashtme (donator dhe grante). Gjatë vitit 2013–2015 janë nisur dhe zhvilluar shumë projekte, ku financime nga IPA-ja, Zvicra dhe Gjermania /KfW, Holanda dhe Italia kanë financuar skema bashkëpunimi rajonal dhe ndërrajonal, kryesisht në fushën e mjedisit, bujqësisë dhe turizmit.

Përvoja në këto bashkëpunime, jep shenja pozitive për synimet e politikës së ardhme për zhvillimin e rajoneve, për krijimin e partneriteteve dhe rrjetëzimeve rajonale dhe ndërrajonale. Ndër qarqet me fare apo aspak eksperiencë bashkëpunimi rajonal, përmendim qarkun e Kukësit dhe Dibrës.

V. DREJTIMET PRIORITARE TË PROGRAMIT OPERACIONAL

Programi operacional përfshin 5 drejtime prioritare, që kanë të bëjnë me ndërhyrje në infrastrukturë dhe akses në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës, qytetet moderne, mbështetjen dhe fuqizimin e ekonomive lokale, kohezionin dhe ndërvendimin rajonal, partneritetin vendor, ndërvendor, ndërrajonal. Mund të aplikohen të gjitha apo disa drejtime prioritare për secilën Zonë të Zhvillimit Rajonal.

Drejtimi prioritar 1. Rivitalizimi i qytetit, fshatit, poliqendrave urbane dhe ekonomive lokale

Shtylla I - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”.

- Masa 1: Rivitalizimi i hapësirave publike, hapësirave me tipare natyrore, zonave dhe infrastrukturës në shërbim të ekonomive lokale.

- Masa 2: Rivitalizimi i poliqendrave urbane dhe qendrave lokale.

- Masa 3: Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës.

- Masa 4: Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve.

Drejtimi prioritar 2. Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal

Shtylla I - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”.

- Masa 1: Përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i atraksioneve (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi).

- Masa 2: Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse ndërvendore, rajonale dhe ndërrajonale.

- Masa 3: Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve urbane, ndërvendore.

- Masa 4: Ngritja e qendrave multifunksionale (edukim-luaj-sport).

Drejtimi prioritar 3. Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, *cluster* të zhvillimit

Shtylla I - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”.

- Masa 1: Promovimi i ngritjes së itinerareve kulturore/turistike (infrastrukturë akses etj.)

- Masa 2: Stimulimi i investimeve në grupime zonash me interes turistik, bujqësor etj.



- Masa 3: Promovimi dhe fuqizimi i zonave me potencial ekonomik (investime për krijimin e vlerës së shtuar).

Drejtimi prioritar 4. Qytetet moderne

Shtylla IV - Programi “Shqipëria dixhitale” - Granti 1. “Shqipëria dixhitale”.

- Masa 1: Platforma inovative me të dhënat e qyteteve në shërbim të qytetarëve.

- Masa 2: Sisteme dixhitale multifunksionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve në shërbim të qytetarëve.

- Masa 3: Shërbime vendore dixhitale për qytetarët dhe biznesin bazuar në zgjidhjet “Në një sportel” nëpërmjet platformave të integruara.

Drejtimi prioritar 5. Mbështetje për ekonominë

Shtylla II - “Programi i mbështetjes për ekonominë”, - granti 1: “Mbështetje për ekonominë” dhe masa të tjera.

- Masa 1: Mbështetje financiare për zhvillim ekonomik dhe nënprogramin e zhvillimit rajonal dhe lokal përmes mbështetjes së NVM-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme).

VI. FINANCIMI

1. Burimi i financimit

Për vitin buxhetor 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është planifikuar në shtylla kryesore financimit, specifikuar si më poshtë vijojnë:

A. Shtylla I: Programet e zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe Rajonale: që përbëhet nga grantet, për:

- a) infrastrukturën vendore dhe rajonale;
- b) arsimin (arsimin bazë; arsimin e mesëm; arsimin universitar);
- c) shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
- d) artin dhe kulturën;
- e) ujësjellës-kanalizime; dhe
- f) rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimi.

B. Shtylla II: Programi i Mbështetjes për Ekonominë: që përbëhet nga granti, për:

- a) Granti për mbështetjen financiare për zhvillim ekonomik dhe nënprogramin e zhvillimit rajonal dhe lokal përmes mbështetjes së NVM-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme).

C. Shtylla III: Programi “Shqipëria dixhitale”, që përbëhet nga granti, për:

- a) Shqipërinë dixhitale.

VII. PERFORMANCA DHE MONITORIMI

Ky seksion përshkruan kornizën institucionale për zbatimin dhe monitorimin e programit

operacional 2016–2017, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aneksin 3, të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

1. Strukturat e përfshira

Në funksion të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe bazuar në kuadrin ligjor përkatës, janë ngritur strukturat si më poshtë vijojnë:

- Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i kryesuar nga Kryeministri, ka në përbërjen e tij ministritë përkatëse të linjës, shoqatën e qarqeve të Shqipërisë, shoqatën e bashkive të Shqipërisë, shoqatën e autonomisë vendore dhe përfaqësues nga Bordet e Partnerëve për Zhvillim, të secilës agjenci të zhvillimit rajonal.

- Sekretariatet teknike, pranë ministrive përkatëse të linjës respektivisht në Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është pranë Kryeministrisë, si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

1.1 Autoriteti i menaxhimit të procesit

Komiteti është struktura institucionale e cila miraton shpërndarjen e financimit dhe menaxhimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky komitet siguron koherencën strategjike të politikave rajonale dhe kombëtare, me synim përmbushjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit rajonal. Komiteti miraton:

- Programin kombëtar operacional për zbatimin e Fondit sipas programeve të shtyllave I, II dhe III;

- Drejtimet strategjike të thirrjes për financim, sipas programeve të shtyllave I, II dhe III, të aneksit 3, të ligjit të buxhetit;

- Specifikimet, formatet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e granteve, sipas propozimit të Sekretariatit të Përgjithshëm, bazuar në propozimet e sekretariateve teknike;

- Rregulla të hollësishme lidhur me aplikimin, vlerësimin, menaxhimin e performancën, si dhe të mbështetjes me grante mbi bazën e performancës, si dhe sistemet e raportimit e monitorimit (manuale, formate, kriteret e vlerësimit të projekteve, indikatorët e vlerësimit të performancës, formatet e hartimit të programeve operacionale).



1.2 Autoritete të tjera

Sekretariatet teknike, të ngritura në ministritë përkatëse të linjës, (me urdhër të posaçëm të ministrit përkatës), kryejnë funksionet si më poshtë vijojnë:

- Kryejnë vlerësimin teknik-financiar për projektet e paraqitura nga aplikuesit, sipas kriterëve të miratuara paraprakisht, nga Komiteti. Vlerësimi kryhet, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të projekteve, të hartuar sipas programeve respektive të aplikimit;

- Administrojnë aplikimet, e kryejnë procesin e vlerësimit teknik (sipas kriterëve të përcaktuara në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve), të përputhshmërisë financiare e ligjore me ligjin e buxhetit, aneksin 3 dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe të përputhshmërisë me programet e nënprogramet zhvillimore e të impaktit të aplikimeve për financim dhe raportojnë pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve;

- Bëjnë njoftimin zyrtar tek autoritetet kontraktuese për miratimin e financimit, monitorimin e statusit e të ecursë së zbatimit të projekteve;

- Bëjnë vlerësimin e ecursë financiare të përdorimit të fondit (mosrealizimit të fondit) e të zbatimit, realizimit të investimeve e të impaktit të projekteve të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve;

- Bëjnë raportimin vjetor për performancën e financimit e të zbatimit të programeve dhe nënprogrameve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve; dhe

- Bëjnë analizën vjetore, të programojnë dhe të propozojnë pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve politikën dhe drejtimit prioritarë të vitit të ardhshëm dhe të dërgojnë propozimet për programet e nënprogramet e zhvillimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm.

Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, koordinon, në bashkëpunim me sekretariatet teknike, marrjen e masave për organizimin e mbledhjeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. Autoritetet aplikuese

Autoritetet aplikuese, të konsideruara autoritete kontraktuese mund të jenë njësi të qeverisjes lokale, qarqet, subjekte të kompetencave të përbashkëta të

tyre, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, agjencia kombëtare për zhvillimin rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, partneritetet ndërvendore dhe rajonale, agjentë zhvillimorë në nivel lokal dhe/ose rajonal, dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit kur ka marrëveshje bashkëpunimi me bashkinë/bashkitë, partneritete rajonale dhe ndërvendore (ndërkomunore), edhe në formën e shoqërive të përbashkëta tregtare me partneritet privat.

KËRKESË

Nr. 1783, datë 11.4.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse Berat” (shtesa), për pasuritë e llojit “truall”.

Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.



Vlera totale e shpronësimit është 2493068 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA HYRËSE BERAT"
(SHITESA)

Nr.	PRONARI			Z. Kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sip. përgj. (m ²)	Sip. shpron. (m ²)	Çmimi (lekë/ m ²)	Shuma (lekë)	Shuma totale në (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Rruzhdi	Ali	Orizaj	8501	2/175	truall	49	31	4183	129673	129673	Konf. nga ZVRPP-ja
2	Rruzhdi	Ali	Orizaj	8501	2/164	truall	220.6	83	4183	347189	347189	Konf. nga ZVRPP-ja
3	Besim	Bajram	Sherifi	8501	2/166	truall	66	20	4183	83660	83660	Konf. nga ZVRPP-ja
4	Besim	Bajram	Sherifi	8501	2/176	truall	49	15	4183	62745	62745	Konf. nga ZVRPP-ja
5	Ganimete	Kamber	Orizaj	8501	1-May	truall	9224	447	4183	1869801	1869801	Konf. nga ZVRPP-ja
	SHUMA										2493068	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë